



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.1358/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit K.R.U. Prishtina Sh.A., me seli në Prishtinë, rrugën “Hazir Shala”, kundër debitorit ProCredit Bank, me seli Prishtinë, rrugën “Xhorxh Bush”nr.26, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.977/2022 të datës 18.05.2023, me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit K.R.U. Prishtina Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.977/2022 të datës 18.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.977/2022 të datës 18.05.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimi i debitorit të përmbaremit ProCredit Bank, me seli Prishtinë, dhe e ka shfuqizuar urdhri përmbaremit P.nr.121/2021 i datës 04.02.2021 i lejuar nga përmbaremi privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbareme, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovet si e themeltë ankesa e kreditorit, ashtu që të anulohet aktvendimi KPPP.nr.977/2022 të datës 18.05.2023 dhe çështja të kthehet Gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Kreditori K.R.U. Prishtina Sh.A., më 04.02.2021 ka parashtruar propozim për përmbartim në zyrën e përmbartuesit privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori ProCredit Bank, me seli Prishtinë, që t'ia paguaj shumën prej 414.76€ dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim ia kishte bashkëngjitur në origjinal Kartelën Financiare të Konsumatorit Nr. 107038 të lëshuar nga ai në emër të Debitorit. Përmbartuesi më 04.02.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.121/2021 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Debitori më 31.10.2022 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka pretenduar se kërkesa e debitorit është parashkuar, gjithashtu nga data 29.01.2019 është bërë pranim- dorëzimi i objekti që kishte në shfrytëzim debitori, ashtu që qiradhënësi është obliguar të bëjë çregjistrimin e njehsorëve në institucionin përkatëse, andaj i ka propozuar gjykatë që ta aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa Urdhërin Përmbartimor P.nr.121/21 të datës 04.02.2021 të shfuqizojë në tërësi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që Propozimi të refuzohet si i pabazuar dhe Urdhri Përmbartimore P.nr. 121/21 të datës 04.02.2021 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.977/2022 të datës 18.05.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimi i debitorit të përmbartimit ProCredit Bank, me seli Prishtinë, shfuqizohet në tërësi urdhri përmbartimor P.nr.121/2021 i datës 04.02.2021 i përmbartuesit privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se Kreditori në emër të Debitorit i ka nxjerrë Kartelën Financiare të Konsumatorit Nr. 107038, të cilin në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Ekstrakti përmban të dhëna për kreditorin dhe debitorin, objektin, por atij i mungojnë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, meqenëse në ekstrakt nuk ka asnjë të dhënë se për cilat shërbime kemi të bëjmë, pra gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në ekstraktin lëndor nuk është paraqitur objekti i detyrimit, meqenëse në atë nuk përshkruhet shërbimi për të cilin është nxjerrë ekstrakti. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Po ashtu ka theksuar se në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par.1 nënpara. 1.2 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti – Kartelën Financiare të Konsumatorit Nr. 107038 nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Po ashtu ka theksuar se në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbartim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit – Kartela Financiare e

Konsumatorit , rezulton se dokumenti mbi të cilin është mbështetur propozimi për përmbardim dhe mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist , meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afarist. Andaj, edhe ka vendosur si me lartë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se ekstrakti nuk është i përshtatshëm për përmbardim, për shkak se nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist , meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afarist. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 i par. 1 nën para. 1.2 ka rregulluar se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa para. 3 i këtij neni ka përcaktuar se *“Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Gjithashtu sipas nenit 37 të LPP-së përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit “*. Në rastin konkret rezulton se pavarësisht se propozimi për përmbardim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit – Kartela Financiare e Konsumatorit , rezulton se dokumenti mbi të cilin është mbështetur propozimi për përmbardim dhe mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist , meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit. Po ashtu ekstrakti nuk është i përshtatshëm për përmbardim, sepse nga ekstrakti afarist sipas shifrës 107038 rezulton se borxhi në shumën prej 414.76€ është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 03.02.2021, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti nuk është përfshire

periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013 ku me ç'rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Mirëpo, hyrja në raport juridik me palët debitore dhe inicimi i procedurës përbarimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1358/23 dt. 08.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova